



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DIREKTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA E DOGANEVE SHKODËR

Nr. 227 P. 1

Shkodër, më 22 / 01 / 2023

LËNDA: Kërkesë për shpallje publike

DIREKTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DIPARTAMENTI I ANALIZAVE DHE APOSTERIORIT  
SEKTORI I MONITORIMIT TË BORXHIT

DIREKTORIA E BURIMEVE MBËSHTETËSE

Adresa: Tiranë, Kasha Mëzez, Lagjia Fushë Mëzez, autostrada Tiranë-Durrës, km 1,  
Qendra "Pajtoni Bussines Center", kati 5.

Bazuar në nenin 96 të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "Kodi Doganor Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe pikës 4 të nenit 162 të Ligjit Nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodit të Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë", 4. "...organi publik publikon aktin në faqen e tij të internetit dhe ..." kërkojmë shpalljen publike për;

- **Vendimin e Gjykatës Administrative Shkalla e Parë Shkodër Nr. 216 (663) datë 30.06.2022**, për debitorin, **Rei Riza Shpuza I** datëlindjes 01.07.1996, me Numër Personal Identifikimi **J60701093N** me Adresa: Ibrahim Hasmema, nd.2, H.1, Njësia Administrative Nr.1, Njësia Bashkiake Nr. 1, 1004, Tiranë

Ju falenderojmë për bashkëpunimin.

KRYETAR

Aida DIZDARI






REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË  
SHKODËR

Juniste C  
30.11.2022

Nr. 216 (31134-00466-83-2022) Regjistri Themeltar  
Datë 25.05.2022 (Depozitimi)  
Datë 26.05.2022 (Shorti)  
Datë 08.06.2022 (Rishortimi)  
Datë 21.06.2022 (Marrë në dorëzim)

Nr. i vendimit: 216 (663)

Data e vendimit: 30.06.2022



**V E N D I M**  
**“NË EMËR TË REPUBLIKËS”**

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, e përbërë nga:

**Gjyqtar: Mirjan MUSTAJ**

sot në Shkodër, më datë 30.06.2022 shqyrtoi në dhomë këshillimi çështjen gjyqësore Nr.216 (31134-00466-83-2022) Regjistri Themeltar, që i përket:

- KËRKUES:** Dega e Doganës Shkodër, me adresë: Lagjia “Dobraç”, Shkodër.
- OBJEKTI:** Lëshim Urdhër Ekzekutimi për vendimin Nr.84/4 Prot, datë 21.02.2022 “Për rikuperimin me forcë të borxhit doganor ndaj shtetasit Rei Shpuza, i datëlindjes 01.07.1996, me numër personal identifikimi J60701093N, me adresë: Ali Demi, Nd.108, Njësia Administrative nr.1, Bashkia Tiranë.
- BAZA LIGJORE:** Neni 280 Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe neni 511 e në vijim të Kodit të Procedurës Civile, i ndryshuar.

Në përfundim të shqyrtimit të kërkesës dhe akteve që i bashkëngjiten asaj, gjykata, pasi mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, i cili kërkon pranimin e kërkesës, si dhe analizoi çështjen në tërësi,

**VËREN:**

Pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, është depozituar prej palës kërkuare, kërkesa për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, lidhur me vendimin Nr.84/4 Prot, datë 21.02.2022 “Për rikuperimin me forcë të borxhit doganor ndaj debitorit z.Rei Shpuza, i

datëlindjes 01.07.1996, me numër personal identifikimi J60701093N”, në vlerën 3,803,942 (tre milion e tetëqind e tre mijë e nëntëqind e dyzet e dy) Lekë, të nxjerrë nga Dega e Doganës Shkodër, si dhe përjashtimi i kërkuesit nga tarifatat gjyqësore konform nenit 43 të Ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

### **I. Rrethanat e faktit.**

Referuar akteve shkresore të administruara në dosjen gjyqësore, rezulton që nga ana e Autoritetit Vendimarrës të Degës Doganës Shkodër, është marrë Vendimi Nr.95, datë 28.09.2021, me anë të të cilit është shpallur debitor shtetasi z.Rei Shpuza, me numër personal identifikimi J60701093N, në shumën 3,803,942 (tre milion e tetëqind e tre mijë e nëntëqind e dyzet e dy) Lekë. Ky vendim i është dërguar për njoftim debitorit me anë të shërbimit postar, në adresën: Ali Demi, Nd.108, Njësia Administrative Nr.1, Bashkia Tiranë. Referuar njoftimit postar lajmërim-marrje Nr.770/6, me kod RR657531016AA dhe kod RR656898665AA, rezulton që nuk ka qenë i mundur njoftimi i shtetasit z.Rei Shpuza në këtë mënyrë, pasi zarfi postar është kthyer me shënimin “*I panjohur*”.

Ne kushtet sa më lartë, Dega e Doganës Shkodër, me shkresën Nr.811 Prot, datë 17.05.2021, ka kërkuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, informacion në lidhje me adresën e vendbanimit të shtetasit Rei Shpuza. Referuar shkresës Nr.9018/1 Prot, datë 14.06.2021 të Zyrës së Gjendjes Civile, Bashkia Shkodër, protokolluar me Nr.811/2 Prot, datë 15.06.2021 pranë Degës Doganës Shkodër, rezulton se pala kërkuese është informuar që adresa e shtetasit Rei Shpuza është: “*Rruga Ali Demi, Nr. i ndërtesës: 108, Tiranë.*”.

Në rrethana të tilla, Dega e Doganës Shkodër, me shkresën Nr.770/7 Prot, datë 03.11.2021 i ka dërguar sërish për njoftim vendimin e sipërcituar debitorit me anë të shërbimit postar, në adresën: Ali Demi, Nd.108, Njësia Administrative Nr.1, Bashkia Tiranë. Referuar njoftimit postar lajmërim-marrje Nr.770/7, me kod RR655110758AA dhe kod RR651023713AA, rezulton që zarfi postar është kthyer me shënimin “*objekt i pakërkuar*”.

Në rrethanat e mësipërme, Dega Doganës Shkodër, me shkresën Nr.84 Prot, datë 12.01.2022, i është drejtuar Bashkisë Tiranë, Njësia Bashkiake nr.1, Tiranë, me kërkesë për shpalljen publike të Vendimit Nr.95, datë 28.09.2021. Shpallje e cila është konfirmuar nga ana e Njesisë Bashkiake nr.1, Njësia Administrative Tiranë, Bashkia Tiranë, me shkresën Nr.126/1 Prot, datë 19.01.2022. Ndërkohë me shkresën Nr.84/1 Prot, datë 18.01.2022 të Degës së Doganës Shkodër konfirmohet që shpallja publike e vendimit të sipërcituar do të qëndrojë nga data 18.01.2022 deri më datë 27.01.2022, pranë kësaj dege.

Në vijim, me shkresën Nr.84/3 Prot, datë 09.02.2022, Dega e Doganës Shkodër ka kërkuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, publikimin në faqen e internetit të Vendimit Nr.95, datë 28.09.2021, sipas nenit 162/4 të Kodit të Procedurave Administrative. Me shkresën

“Shpallje publike Dega Doganore Shkodër 4”, është konfirmuar publikimi në faqen e internetit të Degës së Doganës Shkodër.

Me argumentin se ka kaluar afati i ankimit dhe i ekzekutimit vullnetar, dhe debitori nuk ka likuiduar borxhin doganor, Dega e Doganës Shkodër ka nxjerrë Vendimin Nr.84/4 Prot, datë 21.02.2022 “Për rikuperimin me forcë të borxhit doganor ndaj debitorit z.Rei Shpuza, i datëlindjes 01.07.1996, me numër personal identifikimi J60701093N”, me adresë: Ali Demi, Nd.108, Njësia Administrative Nr.1, Bashkia Tiranë, me anë të cilit është vendosur: “1. Të sekuestrohen vlerat monetare, kreditë sendet me vlerë të çmuar, valutë të huaj të depozituara në bankë, që i përkasin debitorit, z.Rei Shpuza, me numër personal identifikimi J60701093N, personave të tretë apo garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit. 2. Të sekuestrohen mallrat, pasuritë e tundshme dhe të patundshme që i përkasin debitorit, personave të tretë apo garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit. 3. Sekuestrimi i mësipërm të kryhet deri në masën që të bëhet e mundur plotësimi i detyrimeve të mësipërme të përcaktuar në vendimin Nr.95, datë 28.09.2021, të Degës së Doganës Shkodër, si dhe të kamatëvonesave të lindura në bazë të nenit 245 pika 1/b të Kodit Doganor deri në ditën e likuidimit të borxhit doganor.” Ky vendim i është dërguar për njoftim debitorit me anë të shërbimit postar, në adresën: Ali Demi, Nd.108, Njësia Administrative Nr.1, Bashkia Tiranë. Referuar njoftimit postar lajmërim-marrje Nr.84/4, me kod RR255403248AA dhe kod RR253237653AA, rezulton që nuk ka qenë i mundur njoftimi ndaj shtetasit z.Rei Shpuza, për shkak se zarfi është kthyer nga shërbimi postar me shënimin “Larguar”.

Në kushte të tilla, Dega Doganës Shkodër ka operuar me shpallje publike, dhe në këtë kuadër me shkresën Nr.519 Prot, datë 17.03.2022, ka konfirmuar që shpallja publike e vendimit të sipërcituar do të qëndrojë nga data 17.03.2022 deri më datë 26.03.2022, pranë kësaj dege. Ndërsa me shkresën Nr.519/1 Prot, datë 17.03.2022, Dega Doganës Shkodër i është drejtuar Njesisë Administrative Nr.1, Bashkia Tiranë, me kërkesë për shpalljen publike të Vendimit Nr.84/4 Prot, datë 21.02.2022. Shpallje e cila është konfirmuar nga ana e Njesisë Administrative Nr.1, Bashkia Tiranë me Nr.810/1 Prot, datë 24.03.2022.

Në vijim, me shkresën Nr.84/5 Prot, datë 17.03.2022, Dega e Doganës Shkodër ka kërkuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, publikimin në faqen e internetit të Vendimit Nr.84/4 Prot, datë 21.02.2022 “Për rikuperimin me forcë të borxhit doganor ndaj debitorit z.Rei Shpuza, i datëlindjes 01.07.1996, me numër personal identifikimi J60701093N”, sipas nenit 162/4 të Kodit të Procedurave Administrative. Me shkresën “Shpallje publike Dega Doganore Shkodër 7”, është konfirmuar publikimi në faqen e internetit të Degës së Doganës Shkodër.

Me shkresën Nr.519/3 Prot, datë 15.04.2022, Degana e Doganës Shkodër ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nëse shtetasi z.Rei Shpuza, me numër personal identifikimi J60701093N, ka ushtruar ankim administrativ ndaj vendimit Nr.95, datë 28.09.2021. Me shkresën Nr.7445/1 Prot, datë 29.04.2022, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka konfirmuar që ndaj vendimit Nr.95, datë 28.09.2021, ka ushtruar ankim shtetasi z.Rei Shpuza,

nga ku rezulton që në fund të shqyrtimit të ankimit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka nxjerrë vendimin Nr.3391/1, datë 29.04.2022 duke vendosur: “1. *Mospranimin e ankimit Nr.3391 Prot, datë 22.02.2022 të shtetasit Rei Shpuza me numër personal identifikimi J60701093N, kundër aktit administrativ, Vendimit Nr.95, datë 28.09.2021 të Degës së Doganës Shkodër. 2. Ky ankim konsiderohet sikur nuk është bërë. 3. Kundër këtij vendimi keni të drejtën e ankimit pranë gjykatës brenda afatit ligjor.*”. Ky vendim i është dërguar për njoftim debitorit nëpërmjet shërbimit postar me shkresën Nr.519/6 Prot, datë 12.05.2022, në adresën e Studios Ligjore “Fusha & Partners Law Firm”. Referuar njoftimit postar lajmërim-marrje Nr.519/6, me kod RR031605789AA, rezulton që vendimi i sipërcituar i është njoftuar Studios Ligjore “Fusha & Partners Law Firm”.

Sa më sipër, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, është depozituar prej palës kërkuese, kërkesa për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit, lidhur me vendimin Nr.84/4 Prot, datë 21.02.2022 “Për rikuperimin me forcë të borxhit doganor ndaj debitorit z.Rei Shpuza, i datëlindjes 01.07.1996, me numër personal identifikimi J60701093N”, në vlerën 3,803,942 (tre milion e tetëqind e tre mijë e nëntëqind e dyzet e dy) Lekë, të nxjerrë nga Dega e Doganës Shkodër, si dhe përjashtimi i kërkuesit nga tarifatat gjyqësore konform nenit 43 të Ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

## II. Ligji i zbatueshëm.

Neni 510 i Kodit të Procedurës Civile, ku ndër të tjera sanksionohet: “*Ekzekutimi i detyrueshëm mund të bëhet vetëm në bazë të një titulli ekzekutiv. Janë tituj ekzekutivë: ... e) aktet e tjera që sipas ligjeve të veçanta quhen tituj ekzekutivë dhe ngarkohet zyra e përmbarimit për ekzekutimin e tyre.*”

Neni 511 i Kodit të Procedurës Civile, ku ndër të tjera sanksionohet: “[...] *Shqyrtimi i kërkesës për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit zhvillohet nga gjyqtari pa praninë e palëve. [...]*”.

Neni 280 i Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, ku ndër të tjera sanksionohet: “[...] 4. *Vendimet e marra nga administrata doganore për zbatimin e masave garantuese dhe/ose për rikuperimin me forcë të borxhit bëhen tituj ekzekutivë menjëherë sapo ato i njoftohen debitorit. 5. Ekzekutimi i titujve ekzekutivë të nxjerrë nga administrata doganore, të mbështetur me urdhrin e ekzekutimit të nxjerrë nga autoritetet gjyqësore kompetente, bëhet menjëherë në bazë të dispozitave të parashikuara nga nenet 511 e në vazhdim të Kodit të Procedurës Civile. Ekzekutimi mund të bëhet edhe nga strukturat e mbledhjes me forcë të detyrimit pranë administratës doganore. [...]*”.

Neni 281 i Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, ku ndër të tjera sanksionohet: “1. *Çdo person ka të drejtë të ankohet kundër çdo vendimi të marrë nga autoritetet doganore, në lidhje me një borxh dhe/ose vendosjen e sanksioneve në lidhje me zbatimin e këtij Kodi. 2. E drejta e ankimit mund të ushtrohet fillimisht pranë*

*Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave e, më pas, përpara autoriteteve gjyqësore, sipas dispozitave në fuqi.”.*

Neni 283 i Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, ku ndër të tjera sanksionohet: “*Ankimi ndaj vendimit të autoriteteve doganore kompetente për vendosjen e sanksioneve nuk shkakton pezullimin e zbatimit të vendimit në konflikt*”.

Neni 104 i Kodit të Procedurave Administrative, i titulluar “*Fillimi dhe përfundimi i pasojave juridike të aktit administrativ*”, ku sanksionohet: “*1. Një akt administrativ fillon të sjellë pasoja juridike ndaj palës së cilës i drejtohet apo interesat e së cilës preken nga akti, me njoftimin e përmbajtjes së aktit palëve. 2. Akti administrativ i miratuar në heshtje fillon të sjellë pasoja juridike, në ditën e përfundimit të afatit për njoftimin e tij, sipas nenit 97 të këtij Kodi. 3. Një akt administrativ mund të fillojë të sjellë pasoja juridike në një datë tjetër, të caktuar shprehimisht nga vetë akti, por në asnjë rast përpara njoftimit të palës, sipas pikës 1 të këtij neni. Në këtë rast, data e fillimit të pasojave juridike caktohet shprehimisht në pjesën e dispozitivit të aktit administrativ të shkruar. [...].”.*

Neni 162 i Kodit të Procedurave administrative, i titulluar “*Njoftimi publik*”, ku sanksionohet: “*1. Njoftimi publik bëhet në këto raste: a) kur palët janë të panjohura; b) kur vendi për njoftimin nuk është i njohur dhe njoftimi nuk është i mundur, sipas nenit 151 të këtij Kodi; c) kur çdo formë tjetër njoftimi është e papërshtatshme apo e pamundur; ç) në çdo rast tjetër të përcaktuar shprehimisht nga ligji. 2. Njoftimi publik bëhet nëpërmjet shpalljes së shkresës në një kënd të posaçëm për njoftimet në selinë e organit dhe në degët ose në zyrat e tij vendore, në prefekturën apo në një vend tjetër dhe ku mendohet se mund të merret dijeni nga ai/ajo, të cilit i drejtohet. 3. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni. Ky afat mund të zgjatet nga organi publik, për shkaqe të justifikuara. Data e shpalljes dhe heqjes së njoftimit përcaktohet në shkresën e vendosur në mjediset e përmendura në pikën 2 të këtij neni. 4. Përveç shpalljes së shkresës në mjediset e përmendura në pikën 2, të këtij neni, organi publik publikon aktin në faqen e tij të internetit dhe gjithashtu mund ta botojë edhe në shtypin e shkruar, në dy gazetatat me tirazh më të madh. 5. Në rastin e njoftimit të një akti administrativ, teksti i shpallur përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 99, të këtij Kodi, me përjashtim të pjesës arsyetuese. Ai shoqërohet me të dhëna për zyrën, vendin dhe mënyrën e njohjes me përmbajtjen e plotë të aktit administrativ.”.*

Neni 164 i Kodit të Procedurave Administrative, i titulluar “*Akti i ekzekutueshëm*”, ku sanksionohet: “*1. Akti administrativ mund të ekzekutohet vetëm pasi ka hyrë në fuqi. 2. Akti administrativ fillon të ekzekutohet: a) pas përfundimit të afatit të ankimit administrativ, nëse nuk është bërë ankim; b) pas njoftimit të aktit administrativ, në qoftë se ankimi administrativ nuk lejohet; c) pas njoftimit të aktit administrativ, në qoftë se, sipas ligjit, ankimi administrativ nuk ka efekt pezullues; ç) pas njoftimit të vendimit për heqjen e efektit pezullues të ankimit, në përputhje me nenin 133 të këtij Kodi; d) pas njoftimit të vendimit që zgjidh ankimin, nëse ky i*

*fundit e ka refuzuar apo nuk e ka pranuar apelimin. 3. Vendimi organit publik, i cili ndryshon aktin e ankimuar, bëhet i ekzekutueshëm pasi i njoftohet palës.”.*

### **III. Vlerësimi i Gjykatës.**

Gjykata paraprakisht vlerëson të theksoj që, në kushtet kur akti që pretendohet nga kërkuesi se përbën titull ekzekutiv, është akt administrativ i nxjerrë nga një organ publik në ushtrim të funksioneve publike, kërkesa për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit është në kompetencën lëndore të gjykatës administrative. Gjykata administrative, duke qenë gjykatë kompetente nga ana lëndore për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve që derivojnë nga një akt administrativ, është po ashtu, kompetente për shqyrtimin e kërkesave të natyrës procedurale lidhur me këtë akt, sikurse është kërkesa për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit. Në këtë kuadër, duke qenë se akti administrativ, Vendim Nr.84/4 Prot, datë 21.02.2022 “Për rikuperimin me forcë të borxhit doganor ndaj debitorit z.Rei Shpuza, i datëlindjes 01.07.1996, me numër personal identifikimi J60701093N”, është nxjerrë nga Dega e Doganës Shkodër, bazuar në nenin 7, 8, 10, 11 dhe 13 të Ligjit nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, Gjykata konkludon që, kërkesa objekt gjykimi, i përket juridiksionit gjyqësor administrativ dhe është në kompetencën lëndore, funksionale dhe territoriale të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. Po ashtu, Gjykata vlerëson se, nuk ekzistojnë parakushte të tjera procedurale që të pengojnë shqyrtimin meritore të kërkesës. Për rrjedhojë, Gjykata do të analizojë në vijim nëse plotësohen kushtet ligjore për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit duke vlerësuar bazueshmërinë në themel të kërkesës objekt gjykimi.

Gjykata çmon të rëndësishme të theksojë që, në kuptim të nenit 510/e të Kodit të Procedurës Civile dhe, nenit 280/4 të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë, vendimi për rikuperimin me forcë të borxhit doganor përbën titull ekzekutiv që në momentin që i njoftohet debitorit. Në këto kushte, që Gjykata të konkludojë lidhur me kërkesën për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit, duhet fillimisht të analizojë nëse akti administrativ, Vendim Nr.84/4 Prot, datë 21.02.2022 “Për rikuperimin me forcë të borxhit doganor ndaj debitorit z.Rei Shpuza, i datëlindjes 01.07.1996, me numër personal identifikimi J60701093N”, i është njoftuar debitorit konform kërkesave ligjore.

Në nenin 280/4 të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë, parashikohet: “*Vendimet e marra nga administrata doganore për zbatimin e masave garantuese dhe/ose për rikuperimin me forcë të borxhit bëhen tituj ekzekutivë menjëherë sapo ato i njoftohen debitorit.*”. Nga interpretimi *a contrario* i dispozitës rezulton që, nëse vendimi për rikuperimin me forcë të borxhit doganor, nuk i është njoftuar debitorit që i kundrejtohet, atëherë jemi në kushtet që ky vendim nuk përbën titull ekzekutiv të vlefshëm për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit. Një parashikim i tillë në Kodin Doganor është në harmoni me nenin 104/1 të Kodit të Procedurave Administrative, i cili, hyrjen në fuqi të aktit administrativ e lidh me njoftimin e këtij akti shtetasit që i kundrejtohet, dhe nenin 164/1 të këtij Kodi, që përcakton se akti administrativ mund të ekzekutohet vetëm pasi ka hyrë në fuqi.

Nga provat e administruara në dosjen gjyqësore rezulton se, Vendimi Nr.84/4 Prot, datë 21.02.2022, i është dërguar për njoftim debitorit me anë të shërbimit postar, në adresën: Ali Demi, Nd.108, Njësia Administrative Nr.1, Bashkia Tiranë. Referuar njoftimit postar lajmërim-marrje Nr.84/4, me kod RR255403248AA dhe kod RR253237653AA, rezulton që nuk ka qenë i mundur njoftimi ndaj shtetasit z.Rei Shpuza, për shkak se zarfi është kthyer nga shërbimi postar me shënimin “*Larguar*”.

Sa më sipër, rezulton se njoftimi i Vendimit Nr.84/4 Prot, datë 21.02.2022, shtetasit kundërvajtës, nëpërmjet shërbimit postar ka rezultuar jo efektiv. Në mungesë të efektivitetit të njoftimit postar, Dega e Doganës Shkodër ka operuar me njoftimin publik të kundërvajtësit. Njoftimi publik është një nga mënyrat e njoftimit që parashikohet në mënyrë eksplicite dhe ezauruese në nenin 162 të Kodit të Procedurave Administrative, vlefshmëria e të cilit kushtëzohet nga respektimi rigoroz i kriterëve dhe kushteve të mirëpërcaktuara në këtë dispozitë.

Referuar nenit 162 të Kodit të Procedurave Administrative, rezulton që njoftimi publik i akteve administrative bëhet vetëm në raste përjashtimore, kur plotësohet të paktën njëri nga kushtet e sanksionuara në pikën 1 të këtij neni, dhe që kjo mënyrë njoftimi të konsiderohet e vlefshme duhen respektuar rigorozisht kërkesat imperative që sanksionon dispozita. Pra, organi publik mund të operojë me njoftim publik në rastet kur: *i. palët që ju kundrejtohet akti janë të panjohura*. Në këtë rast njoftimi i palës nëpërmjet mënyrave të tjera të parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative duket të jetë jo efektiv, pasi nuk mund të pretendohet njoftimi i palës që nuk njihet, personalisht, nëpërmjet një personi të tretë, postës apo nëpërmjet publikimit elektronik (që kërkon jo vetëm që të njihet marrësi por edhe, të jetë vënë në dijeni paraprakisht për datën e saktë kur bëhet publikimi). *ii. kur vendi për njoftimin nuk është i njohur dhe njoftimi nuk është i mundur, sipas nenit 151 të këtij Kodi*. Në këtë rast kundërvajtësi njihet, por nuk dihet vendqëndrimi i tij faktik. Edhe në këtë situatë, e vetmja mënyrë që mund të rezultojë efektive për njoftimin e aktit është nëpërmjet njoftimit publik. *iii. kur çdo formë tjetër njoftimi është e papërshtatshme apo e pamundur*. Është një kategori e gjerë që përveç të tjerash, përfshin sidomos rastet e aktit administrativ kolektiv, ku njoftimi i shumë subjekteve është i papërshtatshëm ose i pamundur. *iv. në çdo rast tjetër të përcaktuar shprehimisht në ligj*. Në këtë situatë të fundit, mundet që pala të njihet, madje ti njihet dhe vendi i njoftimit, por që ligji administrativ material ka sanksionuar në mënyrë eksplicite që njoftimi duhet bërë me anë të njoftimit publik.

Nëse organi publik që obligohet ligjërisht t'i njoftojë palës veprimin administrativ, ndodhet në një rën nga situatat e mësipërme, atëherë mund të operojë me njoftimin publik. Lidhur me mënyrat sesi realizohet dhe vendin ku bëhet njoftimi publik, në pikën 2 të nenit 162, ligjvënësi ka sanksionuar që bëhet nëpërmjet shpalljes së shkresës në një kënd të posaçëm për njoftimet në selinë e organit dhe në degët ose në zyrat e tij vendore, në prefekturën apo në një vend tjetër dhe ku mendohet se mund të merret dijeni nga ai/ajo, të cilit i drejtohet. Ndërkohë në pikën 4 të së njëjtës dispozitë, parashikohet se, përveç shpalljes së shkresës në mjediset e përmendura në pikën 2, të këtij neni, organi publik publikon aktin në faqen e tij të internetit dhe gjithashtu mund



ta botojë edhe në shtypin e shkruar, në dy gazetata me tirazh më të madh. Qëllimi i ligjvënësit është që njoftimi të shpallet në ato mënyra dhe vende ku mund të marrë dijeni shtetasi që i kundrejtohet, në mënyrë që njoftimi të jetë efektiv. Në këtë kuadër, legjislatori ka përcaktuar mënyrat dhe vendet ku duhet të realizohet detyrimisht njoftimi publik nga organi i administratës publike, që njoftimi të konsiderohet efektiv në kuptim të ligjit, dhe nga ana tjetër, i ka njohur gjithashtu organit publik, mundësinë që përpos këtyre mënyrave/vendeve obligative, të mund të realizojë njoftimin publik edhe në mënyra dhe vende të tjera, që vlerësohen si mundësi alternative për marrjen dijeni të shtetasit që i drejtohet njoftimi. Referuar pikës 2 dhe 4 të nenit 162 të K.Pr.Administrative rezulton se, njoftimi publik realizohet nëpërmjet tre mënyrave: i. nëpërmjet shpalljes së shkresës në një kënd të posaçëm për njoftimet në selinë e organit dhe në degët ose në zyrat e tij vendore, në prefekturën apo në një vend tjetër dhe ku mendohet se mund të merret dijeni nga ai/ajo, të cilit i drejtohet (*shpalljes fizike*); ii. nëpërmjet publikimit të aktit në faqen e internetit të organit publik (*publikimit elektronik*); iii. nëpërmjet botimit në shtypin e shkruar, në dy gazetata me tirazh më të madh (*botimit në shtypin e shkruar*). Ligjvënësi ka përcaktuar imperativisht se njoftimi publik konsiderohet i realizuar sipas ligjit, vetëm atëherë kur është realizuar nëpërmjet zbatimit kumulativ të mënyrës së parë (*shpalljes fizike*) dhe mënyrës së dytë (*publikimit elektronik*). Ndërkohë që njoftimin publik nëpërmjet mënyrës së tretë (*botimit në shtypin e shkruar*), ligjvënësi e ka lënë në diskrecion të organit publik, i cili në varësi të rrethanave të rastit konkret, mundet ose jo ta aplikojë.

Gjykata çmon të rëndësishme të evidentojë se, ligjvënësi e ka kushtëzuar efektivitetin ligjor të njoftimit publik, me aplikimin e njëkohshëm të mënyrës së parë (*shpalljes fizike*) dhe mënyrës së dytë (*publikimit elektronik*), dhe një kërkesë e tillë imperative e vendosur nga legjislatori nuk mund të anashkalohet nga organi i administratës publike që realizon njoftimin publik, apo nga gjykata në kuadër të vlerësimit të efektivitetit të njoftimit publik. Në çdo rast kur vlerëson se plotësohen kushtet dhe kriteret ligjore për të operuar nëpërmjet njoftimit publik, organi i administratës publike është i obliguar ligjërisht të realizojë njoftimin publik njëkohësisht nëpërmjet mënyrës së parë (*shpalljes fizike*) dhe mënyrës së dytë (*publikimit elektronik*). Mosrespektimi i këtij detyrimi ligjor cenon efektivitetin e njoftimit publik, duke bërë që ky njoftim të konsiderohet jo në përputhje me kërkesat e nenit 162 të K.Pr.Administrative.

Në rastin konkret, Gjykata çmon se plotësohen kushtet që të operohet me njoftimin publik të debitorit, pasi, pavarësisht që dihej adresa e shtetasit kundërvajtës, referuar njoftimit postar, shtetasi ka rezultuar “*Larguar*”, ndaj *de facto* nuk dihej adresa reale e tij. Në këto kushte, mënyrat e tjera të njoftimit të parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative nuk do të ishin efektive.

Nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore rezulton që, me shkresën Nr.519 Prot, datë 17.03.2022, Dega Doganës Shkodër ka konfirmuar që shpallja publike e Vendimit Nr.84/4 Prot, datë 21.02.2022, do të qëndrojë nga data 17.03.2022 deri më datë 26.03.2022, pranë kësaj dege. Ndërsa shpallja publike pranë Njësisë Administrative Nr.1, Bashkia Tiranë është konfirmuar nga ana e kësaj njësie me Nr.810/1 Prot, datë 24.03.2022. Ndërkohë që me shkresën “Shpallje

publike Dega Doganore Shkodër 7”, të depozituar në dosjen gjyqësore, është konfirmuar publikimi i vendimit të sipërcituar në faqen e internetit të Degës së Doganës Shkodër. Në këto rrethana, rezulton se është realizuar shpallja fizike e aktit në Degën e Doganës Shkodër, që përkon me organin publik ku është konstatuar shkelja, dhe pranë Njesisë Administrative Nr.1, Bashkia Tiranë, që rezulton të jetë adresa zyrtare e debitorit, si dhe publikimi elektronik i aktit në faqen e internetit të organit publik, që praktikisht janë mënyrat dhe vendet më të përshtatshme ku mund të marrë dijeni shtetasi kundërvajtës, duke plotësuar në këtë mënyrë kushtet e parashikuara nga legjislatori në nenin 162/2/4 të Kodit të Procedurave Administrative, për t’u konsideruar efektiv njoftimi publik i aktit objekt kërkesë.

Sa më sipër, rezulton se njoftimi i Vendimit Nr.84/4 Prot, datë 21.02.2022 “Për rikuperimin me forcë të borxhit doganor ndaj debitorit z.Rei Shpuza, i datëlindjes 01.07.1996, me numër personal identifikimi J60701093N”, është kryer konform parashikimeve të nenit 162 të Kodit të Procedurave Administrative, nëpërmjet shpalljes publike. Në këto kushte, ky akt administrativ përbën titull ekzekutiv në kuptim të nenit 104 të Kodit të Procedurave Administrative dhe nenit 280/4 të Kodit Doganor.

Referuar provave të administruara në dosjen gjyqësore rezulton që, ankimi administrativ ndaj vendimit Nr.95, datë 28.09.2021 të Degës Doganës Shkodër, është mospranuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave. Në këto kushte, pavarësisht që shtetasi Rei Shpuza ka ushtruar ankim administrativ pranë Drejtorit të Përgjithshme të Doganave, duke kundërshtuar aktin administrativ objekt kërkesë, për sa kohë nuk është shfuqizuar ky akt dhe nuk është pezulluar ekzekutimi i tij, rrjedhimisht ekzekutimi i Vendimit Nr.84/4 Prot, datë 21.02.2022 “Për rikuperimin me forcë të borxhit doganor ndaj shtetasit Rei Shpuza, me numër personal identifikimi J60701093N”, nuk mund të pezullohet dhe ky vendim përbën titull ekzekutiv.

Në nenin 280/4 të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë, sanksionohet se: “4. *Vendimet e marra nga administrata doganore për zbatimin e masave garantuese dhe/ose për rikuperimin me forcë të borxhit bëhen tituj ekzekutivë menjëherë sapo ato i njoftohen debitorit.*”. Ndërsa në nenin 283 të këtij Kodi parashikohet se: “*Ankimi ndaj vendimit të autoriteteve doganore kompetente për vendosjen e sanksioneve nuk shkakton pezullimin e zbatimit të vendimit në konflikt*”. Në kuptim të dispozitave të lartëcituara rezulton që vendimi për rikuperimin me forcë të borxhit doganor konstituohet titull ekzekutiv menjëherë sapo i njoftohet debitorit, dhe kundërshtimi i tij nuk pezullon ekzekutimin e vendimit. Në këto kushte, Vendimi Nr.84/4 Prot, datë 21.02.2022, përbën titull ekzekutiv në kuptim të nenit 280/4 të Kodit Doganor.

Duke qenë që Gjykata arriti në përfundimin që plotësohen kushtet e vlefshmërisë së titullit ekzekutiv, për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit lidhur me Vendimin Nr.84/4 Prot, datë 21.02.2022, dhe nuk rezulton që detyrimi që ky akt përcakton, të jetë përmbushur në rrugë vullnetare, kërkesa për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, gjendet e drejtë dhe e bazuar nga gjykata dhe duhet të pranohet.

*Lidhur me shpenzimet gjyqësore:* duke qenë se sipas nenit 43 të Ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” parashikohet se për vënien në ekzekutim të vendimeve për kundërvajtjet administrative, organet e administratës shtetërore përjashtohen nga detyrimi për parapagimin e tarifave gjyqësore dhe për veprimet e shërbimit, që kryhen nga administrata gjyqësore dhe përmbaruesi gjyqësor, Gjykata çmon se pala kërkuese, Dega e Doganës Shkodër nuk ka detyrim për pagimin e tarifës së paraqitjes së kërkesës për gjykim sipas nenit 106 të Kodit të Procedurës Civile, ndaj shpenzime operative nuk ka.

### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata, bazuar në nenet 510, 511 të Kodit të Procedurës Civile, nenet 280, pikat 4 dhe 5 të Kodit Doganor si dhe, nenet 148-162 të Kodit të Procedurave Administrative,

### VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës së palës kërkuese, Dega e Doganës Shkodër;
2. Lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për vendimin Nr.84/4 Prot, datë 21.02.2022 “Për rikuperimin me forcë të borxhit doganor ndaj debitorit z.Rei Shpuza, i datëlindjes 01.07.1996, me numër personal identifikimi J60701093N”, me këto të dhëna:
  - a) Kreditori: Dega e Doganës Shkodër.
  - b) Debitori: subjekti Rei Shpuza, i datëlindjes 01.07.1996, me numër personal identifikimi J60701093N, me adresë: Ali Demi, Nd.108, Njësia Administrative Nr.1, Bashkia Tiranë.
  - c) Shuma e detyrimit: 3,803.942 (tre milion e tetëqind e tre mijë e nëntëqind e dyzet e dy) Lekë.
3. Ky urdhër lëshohet në një kopje të vetme;
4. Shpenzime gjyqësore nuk ka;
5. Ky urdhër është i ekzekutueshëm drejtpërdrejt nga organet e palës kërkuese, Dega e Doganës Shkodër ose nga Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror ose Privat;
6. Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankim;
7. Ky vendim t’i njoftohet palës kërkuese, Dega e Doganës Shkodër.

U shpall në Shkodër, në dhomë këshillimi, sot më datë 30.06.2022.

GJYQTAR

MIRJAN MUSTAJ

